

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË TURIZMIT  
ME OBJEKT “ MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIK DHE  
FINANCIAR PËR PERIUdhËN 01.01.2013-31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në AKT, me objekt “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2014 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 45, datë 30.4.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 1012/3 datë 30.04.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Julinda DHAME, Drejtor i Përgjithshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga auditimi u evidentuan shkelje të dispozitave ligjore në drejtim të dokumentimit dhe të evidentimit të të ardhurave që realizohen në AKT. Për pasojë të ardhurat e realizuara nga institucioni në bazë të aktmarrëveshjeve të lidhura me subjektet private, me qëllim promovimin e Turizmit Shqiptar nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në panairët ndërkombëtare të organizuara nga AKT, janë kaluar në të “ardhura jashtë limitit”, në “kapitullin 6”, të cilat për vitin 2013, arrinin në vlerën 4,774,547 lekë, me qëllim që të përdreshin dhe në vitet në vazhdim, pasi të ardhurat e evidentuara në “kapitullin 5” përdoren vetëm në vitin në të cilin krijohen. Kalimi i këtyre të ardhurave në strukturë tjetër buxhetore (kapitullin 6) të trajtuara si të ardhura nga “sponsorizimet” përbën shkelje të UMF nr.2, datë 06.02.2012, pika 193. Nga ana tjetër konstatohet se në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 25.10.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të MTRS” pika c, këto të ardhura janë përdorur nga institucioni 100% duke mos derdhur në buxhetin e shtetit 10% -in e realizimit të tyre. Nga llogaritjet e grupit të auditimit shuma e pa derdhur në buxhet vetëm për periudhën e auditimit është 520,491 lekë.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të analizohet problematika e ngritur duke nxjerrë përgjegjësitë individuale për shkeljen e dispozitave të udhëzimit të ministrisë së financave në zbatim të buxhetit të shtetit si dhe të merren masa të menjëhershme për kthimin e situatës në normalitet, pra riklasifikimin e të ardhurave në zërin e rregullt buxhetor dhe të monitorojë në vijimësi rregullshmërinë e trajtimit të këtyre të ardhurave sipas kërkesave buxhetore. Të saktësohet dhe të derdhet në buxhet pjesa e të ardhurave që duhet ti kalojë atij.

**Menjëherë**

2. Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në subjektet që kanë përfituar “asistencë financiare”, konstatohet se për vitin 2013 dhe 2014, në asnjë rast nuk është kryer kontroll në lidhje me zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet që kanë përfituar statusin “person i stimuluar” në respektim të kreut III, neni 9, pika 2/d, nenit 48/2 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” me ndryshime si dhe kreut I, të Rregullores së Brendshme. Konstatohet se megjithëse kjo problematikë është sjellë në

vëmendje nga strukturat e auditit të brëndshëm të Ministrisë, nuk gjendet asnjë dokument zyrtar që të vërtetojë se institucioni ka përgatitur një plan veprimi masash për të ushtruar kontrole, apo ka ushtruar kontrole dhe saktësuar statusin e gjithë subjekteve të cilët kanë statusin “person i stimuluar”, për faktin nëse subjektet vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin, kanë humbur karakterin turistik të ndërtimeve apo nuk ekzistojnë fizikisht në terren si ndërtime. Për pasojë detyrimi i qirasë dhe zhvillimit i mbartur ndër vite deri në fund të 2014, për 39 subjekte që kanë lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi, rezulton në vlerën 637,176,777 lekë (dhe pse ka marrëveshje që janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga ana e ministrisë përgjegjëse për turizmin), të dhënat tregojnë se vetëm 6 subjekte vazhdojnë aktivitetin. Vetëm për subjektin “S.....”, me statusin “person i stimuluar”, nuk gjendet asnjë e dhënë nëse ka filluar aktivitetin e zhvillimit apo vazhdon të qëndrojë në truallin ku pronar është “shteti” të cilin e ka marrë me qira. Detyrimi deri në janar 2014 për këtë subjekt, është në vlerën 298,498,967 lekë, i cili vjen duke u rritur nga viti në vit dhe ndikon në rritjen fiktive të detyrimeve debitorë për faktin se nuk ka asnjë të dhënë për subjektet (fakt i cilësuar edhe në raportin e auditit të brëndshëm të ministrisë).

-Nga auditimi i ushtruar në lidhje me detyrimin ligjor të AKT për vitin **2013** dhe **2014**, në përmbushje të detyrimeve të saj, në zbatim të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” me ndryshime, VKM nr. 571, datë 5.9.2007 “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit” dhe Rregullores së Brendshme, konstatohet se nuk është përmbushur detyrimi ligjor *për hartimin e programeve të dhënies së asistencës financiare*, për projektet me përparësi turizmin, *për pasojë nuk kemi asnjë tregues për përmirësimin e këtij sektori.*

-Gjithashtu u konstatua se në bilancin e institucionit ndër vite nuk janë evidentuar të gjitha detyrimet e subjekteve që kanë lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi, me ish MTKRS dhe subjekte që kanë përfituar statusin “person i stimuluar”. Referuar akt rakordimit të të ardhurave në fund të vitit 2013, rezultoi se paguajnë qira vetëm 2 subjekte me statusin “person i stimuluar”, nga 39 subjekte që kanë këtë status. Detyrimi i llogaritur ndaj institucionit për këto subjekte në shumën 637,176,777 lekë, nuk shihet në pasqyrat financiare, fakt që sjell riskun e mos ndjekjes në vijimësi të këtyre detyrimeve.

-Gjithashtu nuk rezulton që në pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese të tyre, të ketë të dhëna inventariale për “zonat turistike” dhe sipërfaqet e tyre të dhëna me qira pasi në institucion evidentohen vetëm të ardhurat e realizuara sipas kontratave. Theksojmë se sipërfaqet dhe “zonat turistike” aktualisht nuk janë në administrimin e institucionit.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

-Të merren masa të menjëhershme për ushtrimin e kontroleve në subjektet që kanë përfituar asistencë financiare, duke evidentuar gjendjen faktike të tyre me qëllim saktësimin e statusit të subjekteve që kanë përfituar këtë mbështetje. Të ndiqet në rrugë ligjore përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e qirasë dhe zhvillimit për ato subjekte të cilat dhe pse marrëveshjet e qirasë dhe zhvillimit janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme vazhdojnë të qëndrojnë në truallin(pronë shtet) duke mos paguar asnjë detyrim.

-Të merren masat dhe të evidentohen të gjitha detyrimet e subjekteve sipas marrëveshjeve të qirasë dhe zhvillimit me ish MTKRS, subjekte që kanë përfituar statusin “person i stimuluar”.

-Të plotësohen të dhënat kontabël edhe me sipërfaqet e trojeve të zëna nga subjektet që kanë lidhur marrëveshje qiraje trajtuar si “persona të stimuluar”, të dhëna të cilat duhet të jenë transparente dhe të aksesueshme si për auditim edhe për publikun e gjerë.

## **Menjëherë**

**3.** Nga auditimi u konstatua se në magazinë gjenden mallra promociionale në sasira të konsiderueshme në vlerë totale 12,140,451 lekë, të krijuara ndër vite, të cilat ruheshin në kushte të papërshtatshme, pasi ambienti me lagështirë stimulonte dëmtimin e tyre duke i bërë të papërdorshëm dhe kthimin e tyre në një vlerë të humbur për institucionin (materiale kryesisht janë prej kartoni). Gjykojmë se këto mallra duhen të ishin përdorur në panairë të ndryshme me qëllim promovimi të Turizmit Shqiptar, por prania e tyre në magazinë tregon për një përdorim joefektiv të fondeve buxhetore, apo planifikim të fryrë të nevojave (ky lloj shpenzimi zë rreth 59% të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për këtë institucion).

### ***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të merren masa në drejtim të menaxhimit dhe ruajtjes në kushte sa më optimale të materialeve të cilat janë “gjendje” në magazine duke synuar vënien në efikasitet të këtyre produkteve, duke i dhënë vlerë të shtuar kostos së harxhuar për to shoqëruar kjo me një politikë të studiuar dhe planifikuar të kërkesave të reja për materiale promociionale, të nevojshme për evenimentet që janë në vijimësi.

## **Menjëherë**

**4.** Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me veprimtaritë vjetore turistike që zhvillohen nga Agjencia Kombëtare e Turizmit është konstatuar mungesa e programit vjetor të miratuar nga Ministri që mbulon turizmin. Për pasojë, aktivitetet që nga panairët, konferencat, si dhe aktivitete specifike të tilla si rasti i “Tureve familjarizuese”, “TRAK FEST”, “Festa e Birrës”, etj për të cilat ka program të detajuar ( por jo të përfshira në program vjetor) mungonte lidhja objektive direkte e veprimtarisë së aktivitetit me objektivin e veprimtarisë së AKT të përcaktuar në ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”i ndryshuar, pa përfshirë mënyrën e prokurimit të fondeve që lidhen me realizimin e këtyre aktiviteteve.

### ***Për sa më sipër rekomandoj:***

Nga ana e institucionit duhet të punohet mbi bazë strategjike dhe planeve afatshkurtra dhe afatmesme, nga të cilat të derivojnë programe vjetore të qarta për veprimtarinë e AKT-së, të cilat duhet të kalojnë në procedurat e miratimit nga Ministria që mbulon aktivitetin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit. Programet vjetore duhet të përcaktojnë analitikisht kostot e çdo aktiviteti, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9374, datë 05.05.2008 “Për turizmin” i ndryshuar dhe detyrimeve të Kreut I, Neni 8/ç të VKM nr. 571, datë 05.09.2007 “Për miratimin e statutit të AKT”. Programi vjetor i veprimtarive, të paraqitet për miratim nga Ministria në periudhën Shtator-Tetor të vitit

paraardhës me synim programimin edhe të aktiviteteve që do të ndodhin në fillimin e vitit pasardhës. Kjo praktikë do të rriste jo vetëm transparencën por edhe efektivitetin e prokurimit të fondeve të nevojshme.

### *Sipas afateve ligjore*

5. Nisur nga fakti se për vitin 2014, fondet e përdorura për evente promociionale zënë rreth 59% të totalit të fondeve buxhetore të vëna në dispozicion të institucionit si pasojë e politikës intensive të promovimit të Turizmit Shqiptar, auditimi u realizua mbi bazë produkti. Konstatohet se nuk ka të dhëna të dokumentuara në lidhje me programimin e panairove që do të organizoheshin jashtë, numrit të pjesëmarrësve në to, përbërjes së delegacioneve (10 panairove të realizuara në vitin 2014), me qëllim evidentimit me detaje të objektivit të çdo evenimenti dhe nga ana tjetër nuk ka indikatorë të pritshëm dhe të matshëm, lidhur me eventet e realizuara dhe vlerës së shtuar të tyre në promovimin e Turizmit Shqiptar dhe tërheqjes së investitorëve të huaj në këtë sektor.

-Në rastin e Panairit të I.T.B Berlin për vitin 2014, kanë marrë pjesë dhe gazetarë që nuk janë punonjës të AKT, për të cilët është bërë rimbursimi i shpenzimeve të akomodimit në hotel, dieta, bileta udhëtimi me avion etj, në vlerën 2626.50 euro, veprim që bie në kundërshtim me VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pa lidhur me ata kontrata punësimi apo shërbimi, pavarësisht aktivitetit të kryer për promovimin e turizmit etj. Për sa më sipër, pagesat e kryera për këtë kategori sjellin si pasojë shpenzim jo efektiv nëse ato nuk justifikohen me dokumentacion (kontratë) pavarësisht realizimit të aktivitetit.

-Gjithashtu dhe nga auditimi i dokumentacionit për blerjen e biletave të avionit, për shërbimet jashtë shtetit të kryera nga punonjësit e AKT, janë konstatuar veprime e procedura të pambështetura në aktet ligjore të prokurimit dhe në ligjin për Turizmin, duke sjellë shpenzim jo efektiv në vlerën totale 1,444,526 lekë për arkën e shtetit, pasi është përdorur për blerjen e tyre procedura e emergjencës me justifikimin e mungesës së kohës në dispozicion për kryerjen e procedurave me blerje të vogël.

#### ***Për sa më sipër rekomandoj:***

-Institucioni të marrë masa që të dokumentojë që në fazën e planifikimit, numrin e pjesëmarrësve në evenimente dhe panairove të ndryshme të organizuara nga AKT, brenda vendit dhe jashtë Shqipërisë, pritshmërinë e synuar nga AKT për këto panairove, me qëllim jo vetëm realizimin e shpenzimeve që kanë vlerë të shtuar por dhe që përmbushin qëllimin dhe objektivat e AKT, në drejtim të promovimit të Turizmit Shqiptar. Ndërkohë rekomandojmë me forcë të punohet për të përcaktuar një set treguesish që do të sigurojnë në vijimësi matjen e produktit që vjen nga promovimi/promovimet e realizuara sipas specifikave të eventeve dhe kostove të realizimit të tyre.

-Angazhimi dhe pjesëmarrja e personaliteteve të kulturës dhe turizmit, mediave apo fushave të lidhura me promovimin e turizmit në panairove/aktivitete të ndryshme jo vetëm që duhet të jetë e planifikuar por dhe e dokumentuar mbi bazë të një kontrate,

ku të specifikohen qartë të drejtat dhe detyrimet që lindin mes palëve bazuar në legjislacionin në fuqi.

### *Menjëherë*

**6.** Nga auditimi është konstatuar se për harxhimin e karburantit, nuk janë zbatuar rregullat për caktimin e normativave, si dhe faktit që dokumentacioni i lëvizjes së mjetit të AKT (ose me qira), nuk është plotësuar sipas rregullave ligjore, konkretisht mungon procesverbali i komisionit të specialistëve që ngrihet me urdhër të titullarit për përcaktimin e gjendjes teknike të mjetit dhe sasinë e karburantit që harxhohet nga mjeti për 100 km. Konstatohet se institucioni ka blerë karburant për periudhën kur institucioni nuk ka patur makinë në gjendje pune me vlerë 903,360 lekë me TVSH, ndërkohë edhe për periudhën kur është marrë një makine me qira normativa e harxhimit është e paargumentuar ligjërisht, shpërndarja e sasisë së karburantit nga AKT është bërë mbi bazën e normativës 18 litra për 100 km, sasia e karburantit e blerë gjatë vitit 2014 për 1 makinë që ka qenë në dispozicion vetëm për 4-mujorin e tretë të vitit ishte 6700 litra.

#### *Për sa më sipër rekomandoj:*

Drejtoria e AKT të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e komisioneve me specialist të fushës, për të përcaktuar gjendjen teknike të mjetit, përllogaritjen e saktë të sasisë të nevojshme të karburantit për 100 km. Gjithashtu, të merren masa për plotësimin e rregullt të dokumentit të fletë udhëtimit në cdo kohë.

### *Vazhdimisht*

**7.** Nga auditimi u konstatua se me urdhër të titullarit të AKT janë zgjidhur kontratat e punës në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, për 3 punonjës, të cilat kanë paditur AKT. Gjykatat kanë pranuar paditë e punonjëseve dhe kanë kërkuar dëmshpërblimin nga institucioni për tre punonjëset për shumën totale **1,917,445 lekë**. Nga Agjencia Kombëtare e Turizmit janë kryer pagesat të pjesshme për tre punonjëset, por konstatohet se për pagesat e kryera për ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore në asnjë rast nuk janë analizuar shkaqet dhe përgjegjësitë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 të Ministrisë së Financave datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” kapitulli “Vendimet gjyqësore

#### *Për sa më sipër rekomandoj:*

Nga institucioni të ketë një analizë të kujdesshme të gjetjeve të këtij raporti dhe të lihen detyra konkrete në zbatim të Udhëzimit nr.2 të Ministrisë së Financave datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” kapitulli “Vendimet gjyqësore”, lidhur me nxjerrjen e përgjegjësive individuale për mos ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe shpenzimin joefektiv në nivelin 1,917,445 lekë.

### *Menjëherë*

**8.** Nga auditimi dosjeve të personelit u konstatua se në kundërshtim me dispozitat e neneve 20 dhe 22 të Ligjit 154/2013 “Për nëpunësin civil” është kryer rekrutimi i 5

punonjësve. Emërimi i Drejtores së Drejtorisë së Marketingut dhe Imazhit është kryer në kundërshtim me dispozitat e pikës 1 dhe 2, të nenit 26 të Ligjit nr. 154/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 545, dt. 11.08.2011, i ndryshuar “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabinetit të Kryeministrit, aparatet e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit, komisionit Qendror të Zgjedhjeve etj”.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Në zbatim të nenit 20,22 të Ligjit nr. 15/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.108, datë 06.02.2014 “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil” dhe VKM nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, institucioni të nisë procedurat e shpalljes së konkursit për pozicionet e Drejtorit të Drejtorisë së Marketingut dhe Imazhit, Përgjegjës të Sektorit të Marketingut, Specialistit të Sektorit Juridik dhe Specialistit të Sektorit të Imazhit.

Në procedurat e rekrutimit të punonjësve të synohet rekrutimi i punonjësve me përvojë dhe nivel profesionalizmi të përshtatshëm për nivelin e institucionit që promovon turizmin shqiptar si brenda dhe jashtë vendit.

***Menjëherë***

9. Nga auditimi konstatohet se nuk është hartuar dhe miratuar Strategjia institucionale e cila përmban objektivat strategjike/prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Nuk janë miratuar plane veprimi për arritjen e qëllimeve strategjike që përmbajnë afate dhe personat përgjegjës për çdo veprim të parashikuar në kundërshtim me nenin 9 të ligjit “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk është hartuar regjistri i riskut sipas dispozitave të nenit 12 dhe nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut sipas dispozitave të nenit 21 të ligjit “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 të ligjit “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nga titullari i institucionit nuk janë përcaktuar rregulla të brendshme mbi zbatimin e firmës së dyfishtë.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

-Titullari i Institucionit të nxjerrë urdhrat përkatës për hartimin dhe miratimin e Strategjisë institucionale si dhe të miratojë planet e veprimit për arritjen e qëllimeve strategjike. Të hartohet regjistri dhe strategjia e riskut sipas përcaktimeve të nenit 12 dhe 21 të Ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Titullari i institucionit, të nxjerrë urdhrin mbi zbatimin e firmës së dyfishtë në zbatim të nenit 22, të ligjit “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Titullari i institucionit në zbatim të neneve 12/dh, 16 dhe 23, të ligjit për MFK, përcaktimeve të pikës 121 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 dhe Urdhrit nr. 92, dt. 29.12.2011 të Ministrit të Financave “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, të nxjerrë urdhrat përkatës për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit.

***Menjëherë***

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

1. *Nisur nga konstatimi se janë marrë për nevojat e aktivitetit të AKT, ambiente me qira në sipërfaqe 700 m<sup>2</sup>, të pa argumentuara dhe të pajustificuara*, pasi së pari, ambienti nuk është i disponueshëm plotësisht nga institucioni për magazinim së dyti, sipërfaqja e saj nuk justifikon qëllimin për të cilin është marrë me qira pasi nga verifikimi i gjendjes së magazinës rezultoi se kishte dhe artikuj të tjerë që nuk janë pjesë e inventarit të kësaj magazine. Për pasojë subjekti P..... shpk si qiradhënës, është paguar në shumën prej 288,000 lekë. Pagesat e kryera me urdhër të Titullares përbëjnë keqadministrim të fondeve buxhetore. Nga verifikimet e kryera në datë 9.01.2015, nuk u konstatuan mallra e materiale të identifikueshme sipas rregullave të kontabilitetit. Malli i gjetur në vlerë 456,000 lekë, është bërë hyrje në magazinë me datë 18.12.2014, pas 9 muaj likuidimi qiraje. Këto veprime bien ndesh me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4/germa ç, neni 2, neni 8, neni 12, neni 13.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), për kërkimin e shpërblimit të dëmit në vlerën **288,000 lekë** nga subjekti P..... Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar, në të kundërt të dëmshpërblehet nga Znj. .... Drejtore e Burimeve Njerëzore e Financës dhe Znj. ...., Drejtori i Përgjithshëm i AKT.

***Menjëherë***

2. *Nga auditimi i zbatimit të kontratës dhe marrjes në dorëzim të mallit për tenderin “Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I.T.B.Berlin”, referuar dokumentave të magazinës dhe verifikimit fizik të gjendjes së magazinës, u konstatua se nuk është bërë hyrje artikulli “tabelë reklamuese LED” me vlerë 96,000 lekë dhe artikulli “stenda operatori”, copë 12, me vlerë 72,000 lekë pas mbarimit të panairit. Për pasojë mungesa e artikujve “tabelë reklamuese LED” copë 1, në vlerën 96,000 lekë dhe “stenda operatori” copë 12, me vlerë 72,000 lekë gjithsej në vlerën totale **168,000 lekë** përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. (*

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën totale **168,000 lekë** nga znj. .... dhe znj. ...., duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi shpërblimi i këtij dëmi.

***Menjëherë***

3. Nga auditimi i pagesave për tenderin “Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I.T.B.Berlin”, referuar urdhër shpenzimit nr.51, datë 28.3.2014, rezulton se është likuajduar subjekti “A.....” sh.p.k. në vlerën 36,000 lekë (me TVSH) për design, ndërkohë që konstatoam se ky zë nuk është tenderuar referuar dokumenteve stadarde të tenderit të publikuar në faqen zyrtare të APP dhe të miratuar nga vetë autoriteti kontraktor.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën totale **36,000 lekë** (me TVSH), nga subjekti A..... sh.p.k përfituar padrejtësisht në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007 i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar, në të kundërt të dëmshpërblehet nga Znj. .... Drejtore e Burimeve Njerëzore e Financës dhe Znj. ...., Drejtori i Përgjithshëm i AKT.

***Menjëherë***

4. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesës për stendën e panairit të Tel Avivit, Izrael, të marrë me qira operatorit O....., është likuajduar ky operator ekonomik mbi vlerën e parashikuar në kontratë në shumën **200,788.50 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi është një shpenzim i pajustikuar nga AKT.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **200,788** lekë nga shoqëria O..... . Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar, në të kundërt të dëmshpërblehet nga Znj. .... Përgjegjëse e Sektorit të Financës e Burimeve Njerëzore, Znj. .... Drejtore e Burimeve Njerëzore e Financës dhe Znj. ...., Drejtori i Përgjithshëm i AKT.

***Menjëherë***

5. Nga auditimi i dokumenteve mbi arredimin e stendës në Panairin e Prishtinës, Kosovë 2014, është konstatuar se firma fituese U....., nuk ka kryer shërbimet sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë, duke përfituar padrejtësisht shumën 19,200 lekë.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **19,200** lekë nga shoqëria U..... Sh.p.k. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar.

***Menjëherë***

6. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesës për dieta e akomodim në hotel, për shërbimet i kryera brenda vendit nga punonjësit (jashtë qendrës së punës), janë konstatuar veprime në kundërshtim me kërkesat e bazës ligjore, VKM nr.997, date 10.12.2010 i ndryshuar. Janë paguar dieta për shërbimet e kryera në qytete e zona me largësi nën 100 km nga qendra e punës dhe në ditët e pushimit javor.

***Për sa më sipër rekomandoj:***



Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga **16 persona** (sipas listës nr.3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit) në vlerën **52,110 lekë**, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbarimorë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Kodin Civil, neni 640. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar pasi personat e lartpërmendur kanë përfitim pa të drejtë nga shërbimet e dietat.

*Menjëherë*

**7.** Për shërbimet e kryera nga punonjësit e AKT, jashtë vendit për pjesëmarrje në panairë e evenimente të ndryshme, është konstatuar se janë rimbursuar shpenzime për transportin e brendshëm urban, taksi e tramvaje, duke mos zbatuar bazën ligjore, siç është VKM nr.870, date 14.12.2011.

*Për sa më sipër rekomandoj:*

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e nga personat sipas listës nr.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në vlerën **773 euro dhe 39 mijë lekë**. Të ndiqen të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbarimorë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Kodin Civil, neni 640. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar për përfitim të padrejtë të shpenzime për transportin e brendshëm urban, taksi e tramvaje në shërbimet jashtë vendit.

*Menjëherë*

**8.** Nga auditimi i dokumenteve mbi zbatimin e dispozitave ligjore për blerjen e materialeve promocionale, spoteve dhe të kohës televizive, në prodhimin e tre spoteve sensibilizuese për qytetarët shqiptar, është konstatuar mosrespektim i kërkesave të AKT, shprehur në specifikimet teknike, sidomos lidhur me kohëzgjatjen e tyre. Mosrealizimi i spoteve me kohëzgjatjen e kërkuar, shprehur në vlerë, ka shkaktuar dëm ekonomik për AKT.

*Për sa më sipër rekomandoj:*

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga shoqëria E..... Sh.p.k, të shumës **651,000 lekë**, që përfaqëson vlerën e 15 sekondave, të porealizuara në tre spotet. Të ndiqen të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbarimorë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Kodin Civil, neni 640. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar.

*Menjëherë*

**9.** Për prodhimin e vendosjen në pikat e caktuara doganore e kufitare, të 11 Info Point-eve nga shoqëria U....., për vlerën 1,712,184 lekë me TVSH, është konstatuar se nuk është zbatuar afati sipas kontratës. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës, rezulton se nga zbatimi me vonesë i kontratës me 20 ditë, nuk janë llogaritur penalitetet. Sipas dokumenteve rezulton se, për vonesën në furnizimin e vendosjen e Info Point-eve, operatori ekonomik U..... duhet të penalizohet me vlerën 136 974 lekë.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **136,974 lekë**, nga shoqëria U..... Sh.p.k. Të ndiqen të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbarmorë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Kodin Civil, neni 640. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar.

***Menjëherë***

**10.** Për zbatimin e kushteve të kontratës mbi ideimin dhe realizimin e portalit akt.gov.al, nga firma E....., është konstatuar mosrespektimi i afateve kohore dhe moslllogaritja e penalteteve për kryerjen me vonesë të shërbimit.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **41,760 lekë** nga shoqëria E..... Sh.p.k. Të ndiqen të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbarmorë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Kodin Civil, neni 640. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar.

***Menjëherë***

**11.** *Nisur nga konstatimi mbi auditimin e përdorimit të ardhurave dytësore rezultoi se:*

-Fondet e përdorura nga të ardhurat dytësore për shpenzime fjetje në hotele për aktivitetin M..... në shumën prej **626,490 lekë** janë kryer në kundërshtim me objektin e veprimtarisë së AKT dhe natyrën e shpenzimit të të ardhurave dytësore, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit bazuar në Urdhrin nr. 405, datë 15.12.2014 të Titullares “Për shpenzime akomodimi për aktivitetit Miss Globe 2014”.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

-Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirren aktet administrative), me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **626,490 lekë** nga subjekti X..... duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë, administrativë e përmbarmorë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Kodin Civil, neni 640. Të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat për shumën e sipërcituar. Në të kundërt kjo vlerë të zhdëmtohet nga ana e Titullares së Institucionit si urdhëruese e këtij shpenzimi.

***Menjëherë***

## **C. MASA DISIPLINORE**

**I.** Mbështetur në nenin 9/4 të Ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin” i ndryshuar, VKM nr. 571, datë 5.9.2007 “Për miratimin e statutit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit” kreu III, neni 8/1 dhe VKM nr. 173, datë 7.3.2007 “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra e drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit”, pika 3 dhe 5, **ministri përgjegjës për turizmin (sot Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes)**, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

*“Shkarkim nga detyra” për:*

1. znj. ...., me detyrë Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, pasi në zbatimin e detyrave të saj funksionale janë konstatuar shkelje dhe mangësi në drejtim të:

Prokurimit të fondeve publike dhe konkretisht në:

-Tenderin “*Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I.T.B.Berlin*”, me fond limit 6,651,000 lekë (pa TVSH) ose me vlerë kontrate **6,599,000 lekë pa TVSH/7,918,800** lekë me TVSH, pasi në vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, shërbime etj. hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit për vitin 2014 nuk janë zbatuar kriteret e përcaktuara për prokurimet publike, nuk janë përgatitur preventivat paraprake, të cilat bëhen për çdo aktivitet promocional dhe miratohen nga titullari i institucionit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Brendshme të institucionit, Kap.II. Si pasojë e këtyre veprimeve janë copëzuar fondet buxhetore, pasi janë kryer procedura prokurimi të llojit “kërkesë për propozim” apo “blerje me vlera të vogla” dhe jo procedura ”tender i hapur”, duke iu shmangur procedurave konkurruese të prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu VI, pika 1/d. Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e fondit limit, është bërë pa analizuar koston e mallrave që duhet të prokurohen, për pasojë nuk ka asnjë preventiv paraprak për llogaritjen e fondit limit, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu II, pika 2/c dhe ç. Me Urdhrin e titullarit nr. 20, datë 28.1.2014 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit i cili rezulton të mos ketë bërë asnjë specifikim teknik minimal për artikujt që prokurohen të tilla si: përmasat, sasia e pixen-vet, pesha specifike, garancia e mallit, certifikatë origjine malli etj për artikullin “tabelë reklamuese LED”, përmasat, materiali, pesha, ngjyra për artikullin “stenda operatori”, konfigurimi për artikullin “printim baner”, nuk ka asnjë specifikim teknik dhe sasi/cmim për artikulli/zërin ”design për të gjitha produktet”. Kjo ka sjellë si pasojë që AK ka tenderuar për një fond limit të pa llogaritur dhe të pa miratuar, të paargumentuar financiarisht, i cili çon në një prokurim mallrash/shërbimesh fiktiv. AKT si autoritet kontraktor, nuk i është drejtuar INSTAT-it me shkresë për marrjen e çmimeve të mallrave që kërkon të prokurohen si dhe nuk i është referuar për marrjen e çmimeve as institucioneve të njohura si organet tatimore/doganore, dhomat e tregtisë etj. ose çmimeve ndërkombëtare të botuara apo çmimeve të kontratave të mëparshme. Në nxjerrjen e Urdhër Prokurimit nr. 27 datë 3.2.2014 nga titullari nuk është argumentuar llogaritja e fondit limit pasi nga AK nuk janë hartuar preventivat paraprakë të aktiviteteve, nuk janë analizuar nevojat për mallra dhe shërbime, AK ka përdorur dhe procedura të tjera prokurimi si prokurimi me blerje të vogla, duke anashkaluar procedurën tender i hapur (materialet promovuese për panairë sic është botimi i broshurave për promovimin e turizmit janë botime që duhet të përdoren në të gjitha këto panairë). Në këtë mënyrë nuk është bërë planifikimi i buxhetit sipas nevojave, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu V, pika 1/ç. Në zbatimin kontratës konstatohet se, mallrat e bëra dalje nga magazina për arredimin e stendës në panairin e Berlinit, nuk rezulton të jenë bërë hyrje në magazinë, pasi në

kartelat e magazinës si dhe nga kontrolli fizik i saj, nuk konstatohet ky fakt, pra nuk dihet se a kanë shkuar në këtë panair pikërisht këto mallra për të cilat është tenderuar. -Tenderin “*Prodhimi i i materialeve promociionale në kuadër të vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri*”, me fond limit 5,338,333 lekë (pa TVSH) dhe vlerë kontrate 6,102,000 lekë me TVSH, përzgjedhja e procedurës së prokurimit nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 2/c të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pasi nga data e shpalljes së vendimit nr.13, datë 23.07.2014 të Komisioni Shtetëror deri me datë 21.9.2014 që është dita e vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri, është kohë e mjaftueshme për të përzgjedhur procedurën e nevojshme të prokurimit për të mos shmangur konkurrencën në prokurim. Gjithashtu në përgatitjen e dokumenteve standarde të tenderit konstatohet se për “kapaciten teknik” është kërkuar një numër punonjësish jo më pak se 35 vetë për periudhën 01janar-31 qershor 2014, kriter i cili nuk tregon gjendjen reale të punonjësve në dispozicion pasi nuk jep garanci nëse ky numër punonjësish në dispozicion dei në fund të qershorit 2014, jep garanci për realizimin e kontratës, në një kohë që tenderi zhvillohet në 13.8.2014, kjo në kundërshtim me Kreun III, pika 3/c, të VKM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar.

Në rolin e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, në blerjet me vlera të vogla pasi:

-ka lejuar shkeljen e rregullave për zbatimin e procedurave të prokurimit, duke miratuar përdorimin e procedurave emergjente për blerjet me vlera të vogla për mallra e shërbime gjatë vitit 2014, si për blerjen e biletave të avionit, marrje me qira të ekranit LED për festen e ditës së verës etj.

-ka lidhur marrëveshje që bien në kundërshtim me Ligjin “Për Turizmin”, si për aktivitetin ATTA, shpenzime transporti e fjetje të personave për aktivitete TRAKU FEST, shpenzime për qira tavolina e stola për festen e birrës Korçë, etj, që nuk kanë lidhje me promovimin e turizmit.

-Nuk ka kërkuar nga vartësit zbatimin e rregullave ligjore për administrimin e karburantit në institucion, duke mos kërkuar mbajtjen e dokumentacionit dhe informim të vazhdueshëm.

*Për shkeljet e konstatuara në mbi marrjen me qira të ambienteve për magazinim për vitin 2014, pasi:*

Për periudhën nga 12.03.2014 deri më 12.01.2015 nga AKT, është marrë me qira një ambient me sipërfaqe prej 700 m<sup>2</sup>, në adresën rruga Gjergj Balsha, nr. 6 pranë Urës Kamëz, Tiranë, për tu përdorur si magazinë për nevojat e institucionit nga shoqëria P..... shpk, referuar kontratës me nr. 295prot, datë 12.03.2014, me vlerë 36, 000 lekë/muaj, e pa justifikuar dhe e pa argumentuar, pasi AKT është akomoduar pranë godinës të Ministrisë së Zhvillimit nga data 01.04.2014, në të cilën përveç ambienteve të zyrave në dispozicion ka në administrim të saj nga momenti i transferimit dhe dy magazina. **Nga ky moment nevojat për magazinim për AKT përballohen nga transferimi i kryer në ambientet e MZHUT.**

Nga verifikimi i kryer në vend më datën 09.01.2015 në magazinën e marrë me qira prej 700m<sup>2</sup> nga grupi i auditimit së bashku me përfaqësuesit e institucionit, rezultoi se: -Ambienti nuk e kryen funksionin e objektit të kontratës së lidhur me 12.03.2014, pasi ambienti nuk i plotëson kushtet e të qenit magazinë. Nga ana e institucionit nuk

disponohet hyrja dhe dalja lirshëm nga ky ambient, pasi institucioni nuk disponon çelësat e këtij ambienti, hyrja dhe dalja nga ky ambient kryhej nga rojet e shoqërisë P..... shpk(qiradhënësi), nuk është i ndarë nga sipërfaqja tjetër prej 19,726 m<sup>2</sup> e subjektit P..... shpk duke mos siguruar kushtet minimale të sigurisë së mallrave objekt magazinimi. Nga verifikimi i dokumentacionit të magazinës rezultoi se i vetmi artikull, në administrim të AKT i cili është konstruksion metalik copë 1 me çmim 456,000 lekë/copë në vlerë 456,000 lekë është vendosur në këtë magazinë (me qira) me datë 18.12.2014 sipas fletë hyrjen nr.109, datë 18.12.2014, pra pas 9 muajsh pagesë qiraje për këtë magazinë. Kjo përforcon konstatimin e grupit të auditimit se nuk kishte asnjë domosdoshmëri dhe nevojë për ambiente të tjera për magazinë për tu marrë me qira. **Pra nga verifikimi në vend i këtij ambjenti nuk rezultoi se i shërbente institucionit për faktin se aty gjendeshin artikuj mallra të ndryshëm të shoqërisë P....., të trajtuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.**

Shuma e pagesave për qira magazine deri më 31.12.2013 të kryera nga institucioni referuar ditarit të bankës është në shumën prej 288,000 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare pasi bie ndesh me neni 4/germa ç të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “, neni 2, neni 8, neni 12, neni 13 të Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Pagesat e kryera me urdhër të Titullares janë bërë duke keqpërdorur fondet buxhetore. Gjithashtu nga verifikimet e kryera në vend datë 9.01.2015, nuk u konstatuan mallra e materiale të identifikueshme sipas rregullave të kontabilitetit. Malli i vetëm i gjetur në vlerë 456,000 lekë, u bë hyrje në magazinë me datë 18.12.2014, pas 9 muaj likuidimi qiraje. Këto veprime bien ndesh me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4/germa ç, neni 2, neni 8, neni 12, neni 13.

**Për shkeljet e konstatuara nga përdorimit të të ardhurave dytësore për vitin 2014, pasi:**

Urdhurat e lëshuara në përdorimin e të ardhurave dytësore për shpenzime bien në kundërshtim me objektin e veprimtarisë së AKT dhe natyrën e shpenzimit të të ardhurave dytësore. Financimi në disa raste nga AKT i projekteve dhe konkretisht financimi i shpenzimeve për akomodim duke përdorur të ardhurat dytësore të cilat kanë destinacion tjetër shpenzimi, kryesisht aktivitete në fushën e turizmit sipas Udhëzimit nr.3, datë 25.10.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të MTKRS”, pika B/4, germa b/2 dhe pika C/2, tregon për keqpërdorim të fondeve buxhetore. Konkretisht janë kryer pagesa për:

-fjetje në hotele për aktivitetin M..... bazuar në Urdhrin nr. 405, datë 15.12.2014 të Titullares, në shumën prej 626,490 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi nga dokumentacioni i subjektit D..... që zhvillon aktivitetin rezulton që, kjo është një shoqatë që merret me organizimin e aktiviteteve për sfilatat e modës dhe konkurset e bukurisë dhe që e ka burimin e financimit të siguruar për fillimin e këtij aktiviteti.

-pagesa për materiale në këtë eveniment në shumën 336,000 lekë të cilat nuk gjenden aktualisht në AKT, shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi janë përdorur fondet nga të ardhurat dytësore të cilat kanë si destinacion vetëm promovim

të turizmit në Shqipëri. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat Ligjin nr. 9734, datë 14.05.2007 “Për turizmin”, i ndryshuar neni 2, neni 9, Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 2, neni 8/pika1, Udhëzimin e Përbashkët të MF dhe ish MTRS me nr.3, datë 25.10.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të MTKRS”pika B 4/ germa b/2 dhe pika C2 paragrafi i fundit qe përbëjnë shkelje të disiplinës financiare.

**II.** Mbështetur në nenin 58, të ligjit nr.152/2013 “Statusi i nëpunësit civil”, miratuar në datën 13.05.2013 dhe kreu II i VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë **Komisionit Disiplinor pranë AKT**, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

*“Largim nga shërbimi civil” për:*

1. znj. ...., me detyrë Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për mosveprim në lidhje me:

-Shkeljet e konstatuara për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare, pasi në bilancin e Aparatit nuk janë evidentuar të gjitha detyrimet e subjekteve që kanë lidhur marrëveshjeve qiraje dhe zhvillimi me ish MTKRS dhe që kanë përfituar statusin “person i stimuluar”. Gjithashtu nuk rezulton që në pasqyrat financiare (shënimet shpjeguese) të AKT të ketë të dhëna inventariale sipas sipërfaqeve të trojeve “zona turistike” pasi në institucion evidentohen vetën të ardhurat faktike sipas kontratave të lidhura

-Keqmenaxhimin, ruajtjen dhe administrimin e aseteve të institucionit pasi aktualisht nuk gjendet asnjë dokument apo urdhër i dalë nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve, për lëvizjen e dhe marrjen e masave në drejtim të ruajtjes së automjeti tip KIA në vlerë 2,988,000 lekë. Gjithashtu nuk janë dokumentuar lëvizjet e automjeteve sipas personave që i kanë pasur në ngarkim me kartelet magazine. Të gjitha shkeljet e konstatuara bien ndesh me neni 12/germa f të Ligjit nr.10296 , datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 2,10 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Keqmenaxhimin e fondeve buxhetore, pasi në Institucioni edhe pse ka në inventar një automjet për nevoja pune ka marrë me qira 1 automjet për të cilën ka harxhuar karburant në vlerë **912,442 lekë** dhe për qira përdorimi automjeti, janë paguar në vlerë **384,000 lekë** subjektit A..... shpk. Shërbim i cili në total i ka kushtuar institucionit **1,296,442 lekë** (shpenzime qiraje automjet dhe shpenzime karburanti) është i pa argumentuar, dhe bie ndesh me Ligjin nr.10296 , datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12.

-Në shkeljet e konstatuara në lidhje me pagesat e kryera subjektit X..... shpk nga datat 03.11.2014 deri më 09.11.2014, duke përdorur të ardhurat dytësore të cilat kanë tjetër destinacion shpenzimi, kryesisht aktivitete në fushën e turizmit, për pagesë akomodimi të 25 personave në eventin Miss Globe 2014, në shumën prej 626,490 lekë, gjithashtu u konstatua se dokumentacioni shoqërues i kësaj pagese ka mangësi në saktësimin e numrit të saktë dhe emrat të pjesëmarrësve në hotel dhe periudhën kohore të akomodimit, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për

menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12/pika 3a, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, pika 36.

-Keqadministrimin e fondeve buxhetore pasi janë marrë për magazinim për nevojat e AKT, ambiente me qira prej 700 m<sup>2</sup>, të pa argumentuara dhe të pajustificuara Gjithashtu nga verifikimet e kryera në vend datë 9.01.2015, nuk u konstatuan mallra e materiale të identifikueshme sipas rregullave të kontabilitetit. Malli i vetëm i gjetur në vlerë 456,000 lekë, u bë hyrje në magazinë me datë 18.12.2014, pas 9 muaj likuidimi qiraje. Këto veprime bien ndesh me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4/germa ç, neni 2, neni 8, neni 12, neni 13.

-Keqmenaxhimin e aktiveve gjendje në magazinën e institucionit, pasi aktualisht qëndrojnë gjendje materialeve dhe botime promocionale në sasi të konsiderueshme në vlerë rreth 12,140,451 lekë të pa shpërndarë dhe të blera ndër vite.

-Lejimin e shkeljeve në llogaritjen e dhënien e dietave brenda vendit, duke mos zbatuar VKM nr.997, date 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.

-Lejimin e shkeljeve në kryerjen e pagesës për qiranë e stendës për Panairin e Tel Avivit 2014, duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 200 788.<sup>50</sup> lekë.

-Lejimin e shkeljeve të rregullave ligjore për përcaktimin e normativave të harxhimit të karburantit dhe ka pranuar dokumenteve justifikuese të parregullt, siç janë fletë udhëtime të pa firmosur nga personat që kanë marrë mjetin në përdorim.

-Miratimin e likujdimit te urdhër shpenzimit nr.51, datë 28.3.2014, *për tenderin “Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I.T.B.Berlin”*, subjektit A..... sh.p.k. në vlerën **36,000 lekë** (me TVSH) për zërin “design për të gjitha produktet”, si zë i pa tenderuar referuar dokumenteve stadarde të tenderit të publikuar në faqen zyrtare të APP dhe të miratuar nga vetë autoriteti kontraktor, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007 i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011.

*“Mbajtjen deri në 1/3 e pagës së plotë për gjashtë muaj”* për:

2. znj. ...., me detyrë Drejtore në Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me:

-shkeljet e konstatuara gjatë përdorimit të të ardhurave dytësore gjatë auditimit të veprimeve me bankën gjatë vitit 2014 ka miratuar dokumentacion (Memo) me nr.817/2 prot. datë 12.10.2014 dhe një relacion në lidhje me financimin e aktivitetit akomodim hoteli të delegacionit të Miss Globe 2014, drejtuar Drejtorisë së Financës dhe e Shërbimeve me objekt kërkesë për pagesën e akomodimit të 25 pjesëmarrësve në Miss Globe 2014 e cila zhvillohet nga datat 23 Tetor deri më 08 Nëntor 2014 në qytetin e Shkodrës, pasi ky aktivitet është një mënyrë promovimi i turizmit veprime këto që bien ndesh me Ligjit nr.9734, datë 14.05.2007 “Për turizmin”, i ndryshuar, neni 9/pika 2a.

-në rolin e anëtares së komisionit të procedurave për prodhimin e transmetimin e emisionit “Të njohim Shqipërinë”, pasi ka lejuar moszbatimin e rregullave për publikimin e ftesës në faqen e internetit të institucionit dhe për pranimin e hapjen e

ofertave të paraqitur në procedurë. Nuk ka zbatuar rregullat për dërgimin e ftesave operatorëve ekonomik të ftuar për të marrë pjesë në procedurën e prodhimit të spotit “Visit Albania”.

- Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në tenderin “*Prodhimi i i materialeve promociionale (gadgets,give,aëay)*” në cilësinë e kryetarit të KVO, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar, kreu V, pika 4/ç.

**3.** Znj. ...., me detyrë ish magazinierë nga 14.01.2014 deri më 25.02.2014, aktualisht specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Financës, aktualisht specialiste në sektorin e burimeve njerëzore e financës, Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve, për mos veprim në lidhje me shkeljet e konstatuara në:

-Mbajtjen, dokumentimin e të dhënave të kontabilitetit pasi në financës nuk është marrë asnjë masë për dokumentimin, përpilimin e kartelave të automjeti tip KIA në vlerë 2,988,000 lekë me të gjitha të dhënat që duhen mbajtur regjistri i aktiveve nga momenti i bërjes hyrje në institucion sipas personave që janë ngarkuar me përdorimin e automjetit, bazuar në kontratat e punës së lidhura më datën 25.02.2014 me z. ...., kontratës me datë 14.05.2014 me z. ...., me z. .... dhe së fundmi me datën 30.12.2014 me z. .... me detyrë punëtor të mirëmbajtjes i emëruar me urdhrin e Titullares me nr.415, datë 30.12.2014, veprime që bien ndesh me pikën 26, 30 të Udhëzimit nr.30 , datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Gjithashtu nuk gjenden dokumente për shpenzimet për riparimet e kryera ndër vite për këtë automjet, të cilat do të saktësonin gjendjen teknike aktuale të mjetit, veprime që bien ndesh me pikën 30 të Udhëzimit nr.30 , datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Në rolin e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2014, për blerjet me vlera të vogla pasi:

-ka miratuar blerjet me emergjencë edhe pse nuk kanë ekzistuar kushtet për një procedurë të tillë, duke lejuar moszbatimin e rregullave të përcaktuara në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr.2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar.

-në blerjen e ekranit LED, ka lejuar ndryshimin e procedurës nga blerje malli në marrje me qira, duke u shmangur nga kërkesat e përcaktuara në dokumentet e blerjes me vlera të vogla.

-Në rolin e specialistes së financës për mbajtjen e plotësimit e dokumentacionit të arkës në valutë, ka lejuar kryerjen e pagesave edhe pse ka pasur mungesa në dokumentacionin justifikues, sidomos ftesat e dërguara nga organizatorët e eventeve për pjesëmarrjen e AKT, boarding pass-et, etj. Në disa raste, janë konstatuar korrigjime në dokumentet e arkës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- në cilësinë e anëtares së Njësisë së Prokurimit në tenderin me objekt *Prodhim i materialeve promociionale në kuadër të vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri*”, për mangësitë e konstatuara në përgatitjen e dokumentacionit standard të tenderit me



vendosjen e kritereve diskriminuese në kundërshtim me kreu II, pika 3/c të VLM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar.

*“Mbajtjen deri në 1/3 e pagës së plotë për 3 muaj”* për:

4. znj. ...., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerezore dhe Financës nga data 01.12.2013 e në vazhdim për mosveprim në lidhje me:

- Shkeljet e konsatuara në evidentimin e të ardhurave dytësore, të cilat janë trajtuar si të ardhura nga sponsorizime të realizuara nga AKT me subjekte të ndryshme private në bazë të aktmarrëveshjeve të lidhura ndërmjet tyre me qëllim promovimin e Turizmit Shqiptar, të organizuara nga AKT dhe të kaluara në të ardhura jashtë limitit, në kapitullin 6 dhe jo në kapitullin 5, me qëllim mos derdhje në buxhetin e shtetit të shumës prej është 430,370 lekë. Kalimi i këtyre të ardhurave në strukturë tjetër buxhetore (kapitulli 6), dhe jo në kapitullin 5, të trajtuara si të ardhura nga sponsorizime përbën shkelje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 193, pasi këto nuk janë të ardhura nga sponsorizime dhe përdorimi i këtyre të ardhurave 100% nga institucioni përbën shkelje të Udhëzimit nr.3, datë 25.10.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të MTRS” pika c/4, pra nuk janë derdhur në buxhetin e shtetit 10% të realizimit të tyre,

-Mosndjekjen e detyrimeve debitore deri në arkëtimin e tyre, të cilat rezultojnë gjendje në fund të vitit 2014,

-Në mos evidentimin në bilancin e institucionit ndër vite, në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, të gjitha detyrimet e subjekteve që kanë lidhur marrëveshjeve qiraje dhe zhvillimi me ish MTKRS dhe që kanë përfituar statusin “person i stimuluar”, detyrime të cilat duhet të arkëtohen nga institucioni,

-Mos evidentimin dhe mbajtjen në financë të kartelës së riparimeve të kryera për këtë automjet KIA në vlerë 2 988 000 lekë ndër vite, veprime që bien ndesh me Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , i ndryshuar neni 5, Udhëzimin nr.30 , datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 1, 2 , 30 .

-Ka lejuar shkelje në përgatitjen e dokumenteve të bankës, duke mos zbatuar detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-likujdimin e urdhër shpenzimit nr.51, datë 28.3.2014, *për tenderin”Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I.T.B.Berlin”*, subjektit A.....sh.p.k. në vlerën **36,000 lekë** (me TVSH) për zërin”design për të gjitha produktet”, si zë i pa tenderuar referuar dokumenteve stadarde të tenderit të publikuar në faqen zyrtare të APP dhe të miratuar nga vetë autoriteti kontraktor, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007 i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011.

5. z. ...., në cilësinë e anëtares së KVO në tenderin me objekt “*Prodhimi i i materialeve promocionale(gadgets,give,aëay)*”:

-për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në tenderin “*Prodhimi i i materialeve promocionale(gadgets,give,aëay)*” në

cilësinë e kryetarit të KVO, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar, kreu V, pika 4/ç.

6. znj. ...., me detyrë specialiste në sektorin e Imazhit Drejtoria e marketingut dhe Imazhit, në rolin e anëtares së komisionit për hartimin e dokumenteve mbi procedurën e blerjes të tre spoteve pasi:

-nuk ka zbatuar rregullat e përcaktuara në VKM nr.1195, datë 5.08.2008, lidhur me përcaktimin e kriterëve mbi bazën e të cilëve bëhet konkurrimi nga ofertuesit, duke ftuar të marrin pjesë në konkurrim operatorë ekonomik pa eksperiencën minimale.

-për blerjet me vlera të vogla të biletave të avionit, ka miratuar blerjet në kushtet e emergjencës, edhe pse nuk kanë ekzistuar kushtet për një procedurë të tillë, duke lejuar moszbatimin e rregullave të përcaktuara në VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr.2, datë 28.03.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla" i ndryshuar.

7. z. ...., me detyrë specialist në sektorin e Projekteve, në rolin e anëtarit të komisionit për hartimin e dokumenteve mbi procedurën e blerjes të tre spoteve, pasi:

-nuk ka zbatuar rregullat e përcaktuara në VKM nr.1195, datë 5.08.2008, lidhur me përcaktimin e kriterëve mbi bazën e të cilëve bëhet konkurrimi nga ofertuesit, duke ftuar të marrin pjesë në konkurrim operatorë ekonomik pa eksperiencën minimale.

8. z. ...., me detyrë specialist, në rolin e anëtarit të komisionit për hartimin e dokumenteve mbi procedurën për blerjen e tre spoteve dhe të programit televiziv "Të njohim Shqipërinë", pasi:

-nuk ka zbatuar rregullat e përcaktuara në VKM nr.1195, datë 5.08.2008, lidhur njoftimin e operatorëve ekonomik të ftuar për të marrë pjesë në konkurrim.

-ka lejuar të marrin pjesë në konkurrim operatorë ekonomik pa eksperiencën minimale.

-ka lejuar moszbatimin e rregullave të përcaktuara në VKM e mësipërme, për publikimin e ftesës për ofertë në faqen e internetit të institucionit dhe të procedurave për pranimin e hapjen e ofertave.

- në mangësitë e konstatuara në përgatitjen e dokumentacionit standard të tenderit me objekt "*Prodhim i materialeve promociionale në kuadër të vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri*", me vendosjen e kriterëve diskriminuese në kundërshtim me kreu II, pika 3/c të VLM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar.

**III.** Mbështetur në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 72/2, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", neni 81, kreu XI, i rekomandojmë **Agjencisë së Prokurimit Publik** që në referim të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 "Statusi i nëpunësit civil", datë 13.05.2013 dhe kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", të kërkojë nga Komisioni Disiplinor pranë AKT për punonjësit që janë aktualisht pranë saj dhe MZHUT për ish punonjësit e AKT që

aktualisht janë punonjës pranë saj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për personat si më poshtë:

***“Largim nga shërbimi civil” për:***

**1.** z. ....,

**2.** z. ....,

pasi në cilësinë e anëtareve të grupit të ngritur me Urdhrin nr. 20, datë 28.1.2014 të titullarit të institucionit, për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit, në: Tenderin *“Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I.T.B.Berlin”*, me fond limit 6,651,000 lekë (pa TVSH) ose me vlerë kontrate 6,599,000 lekë pa TVSH/7,918,800 lekë me TVSH, nuk kanë analizuar koston e mallrave që duhet të prokurohen, për pasojë nuk ka asnjë preventiv paraprak për llogaritjen e fondit limit, nuk kanë hartuar asnjë specifikim teknik për artikujt e kërkuar të tilla si: përmasat, sasia e pixen-vet, pesha specifike, garancia e mallit, certifikatë origjine malli, orët e punës për shërbimin e kërkuar etj për zërat që do prokuroheshin. Për pasojë tenderi rezulton të jetë bërë për mallra të cilat nuk kanë specifikime teknike të dokumentuara, duke u kryer procedurë fiktive tenderimi, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu II, pika 2/ç. Gjithashtu në llogaritjen e fondit limit të kontratës si pasojë e mos hartimit të specifikimeve teknike sipas kërkesave të legjislacionit për prokurimin publik në marrjen e çmimeve për artikujt që do prokuroheshin nuk i janë drejtuar INSTAT-it me shkresë për marrjen e çmimeve, as institucioneve të njohura si organet tatimore/doganore, dhomat e tregtisë etj. ose çmimeve ndërkombëtare të botuara apo çmimeve të kontratave të mëparshme.

-Gjithashtu për z. ...., në rolin e kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2014, ka lejuar marrjen e vendimeve për miratimin e procedurave për blerjen me emergjencë të mallrave (bileta avioni), duke lejuar shmangien e procedurave të rregullta të prokurimit.

***“Mbajtjen deri në 1/3 e pagës së plotë për 3 muaj” për:***

**3.** znj. ...., me detyrë ish juriste e AKT aktualisht juriste në MZHUT, në rolin e kryetares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla, për shkeljet e konstatuara në:

-procedurën e blerjes të ekranit LED, ka lejuar ndryshimin e procedurës nga blerje malli në marrje me qira, duke u shmangur nga kërkesat e përcaktuara në dokumentet e blerjes me vlera të vogla.

-procedurën e blerjes së shërbimit për portalin akt.gov.al, është konstatuar mungesa e dokumenteve mbi të cilët është bërë skualifikimi i operatorëve ekonomik.

***“Vërejtje” për***

**4.** znj. ...., në cilësinë e anëtares së Njësisë së Prokurimit në tenderin me objekt *“Prodhim i materialeve promociionale në kuadër të vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri”*, për mangësitë e konstatuara në përgatitjen e dokumentacionit standard të

tenderit me vendosjen e kriterëve diskriminuese në kundërshtim me kreu II, pika 3/c të VLM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar.

**5.** znj. ...., me detyrë specialiste në sektorin juridik, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve, në rolin e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla, pasi:

-për blerjet me vlera të vogla të biletave të avionit, ka miratuar blerjet në kushtet e emergjencës, edhe pse nuk kanë ekzistuar kushtet për një procedurë të tillë, duke lejuar moszbatimin e rregullave të përcaktuara në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr.2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar.

-në procedurën e blerjes të ekranit LED, ka lejuar ndryshimin e procedurës nga blerje malli në marrje me qira, duke u shmangur nga kërkesat e përcaktuara në dokumentet e blerjes me vlera të vogla.

**6.** znj. ...., me detyrë Drejtor i Marketingut dhe Imazhit, në rolin e kryetares së komisionit për përgatitjen e dokumenteve dhe zbatimin e procedurave për prodhimin e spoteve publicitare dhe në cilësinë e anëtares së KVO në tenderin me objekt “*Prodhimi i i materialeve promociionale (gadgets,give,aëay)*” pasi:

-për blerjet me vlera të vogla të biletave të avionit, ka miratuar blerjet në kushtet e emergjencës, edhe pse nuk kanë ekzistuar kushtet për një procedurë të tillë, duke lejuar moszbatimin e rregullave të përcaktuara në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr.2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar.

-për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në tenderin “*Prodhimi i i materialeve promociionale (gadgets,give,aëay)*” në cilësinë e kryetarit të KVO, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar, kreu V, pika 4/ç.

## **D.MASA ADMINISTRATIVE**

**1.**Nga auditimi për zbatimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” konstatohet se në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 10296, dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nga njësia nuk është hartuar, miratuar dhe përcjellë në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Deklarata e Misionit dhe Pyetëtori i Vetëvlerësimi për cilësinë e sistemeve të kontrollit.

***Për këtë rekomandojmë :***

Në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i kërkojmë Nëpunësit të parë autorizues në Ministrinë e Financës, të vendosë masën e gjobës për znj. .... në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, për shkeljen e dispozitave të nenit 18 të ligjit të sipërcituar.

**Menjëherë**

## F. KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 280,281 të K.Pr.P. i është kërkuar, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimi i procedimit penal për konsumin e veprës penale *shpërdorim detyrë*, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të: **Znj..... Drejtore e Agjencisë Kombëtare të Turizmit**, lidhur me rastet e copëzimit të fondeve, shmangies së procedurave të normale të prokurimit “tender i hapur” dhe aplikimin e procedurave “kërkesë për propozim”, “blerje të vogla” dhe “negocim pa shpallje”, kryerjes së pagesave që nuk përpunohen me objektin e veprimtarisë së AKT-së apo pagesave të panevojshme për AKT-në në favor të subjekteve private, si dhe në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi dhe Ligjin 9734, datë 14.05.2007 “Për Turizmin”. Më konkretisht cilësojmë

-Për tenderin “*Arredimi i stendës për pjesëmarrje në Panairin e I.T.B.Berlin*”, me fond limit 6,651,000 lekë (pa TVSH) ose me vlerë kontrate **6,599,000 lekë pa TVSH/7,918,800** lekë me TVSH, pasi në vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, shërbime etj. hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit për vitin 2014 nuk janë zbatuar kriteret e përcaktuara për prokurimet publike, nuk janë përgatitur preventivat paraprake, të cilat bëhen për çdo aktivitet promociional dhe miratohen nga titullari i institucionit duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Brendshme të institucionit, Kap.II. Si pasojë e këtyre veprimeve janë copëzuar fondet buxhetore, pasi janë kryer procedura prokurimi të llojit “kërkesë për propozim” apo “blerje me vlera të vogla” dhe jo procedura “tender i hapur”, duke iu shmangur procedurave konkurruese të prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu VI, pika 1/d. Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e fondit limit, është bërë pa analizuar koston e mallrave që duhet të prokurohen, për pasojë nuk ka asnjë preventiv paraprak për llogaritjen e fondit limit, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu II, pika 2/c dhe ç. Me Urdhrin e titullarit nr.20, datë 28.1.2014 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit i cili rezulton të mos ketë bërë asnjë specifikim teknik minimal për artikujt që prokurohen të tilla si: përmasat, sasia e pixen-vet, pesha specifike, garancia e mallit, certifikatë origjine malli etj për artikullin “tabelë reklamuese LED”, përmasat, materiali, pesha, ngjyra për artikullin “stenda operatori”, konfigurimi për artikullin “printim baner”, nuk ka asnjë specifikim teknik dhe sasi/cmim për artikulli/zërin “design për të gjitha produktet”. Kjo ka sjellë si pasojë që AK ka tenderuar për një fond limit të pa llogaritur dhe të pa miratuar, të paargumentuar financiarisht, i cili çon në një prokurim mallrash/shërbimesh fiktiv. AKT si autoritet kontraktor, nuk i është drejtuar INSTAT-it me shkresë për marrjen e çmimeve të mallrave që kërkon të prokurohen si dhe nuk i është referuar për marrjen e çmimeve as institucioneve të njohura si organet tatimore/doganore, dhomat e tregtisë etj. ose çmimeve ndërkombëtare të botuara apo çmimeve të kontratave të mëparshme. Në nxjerrjen e Urdhër Prokurimit nr. 27 datë 3.2.2014 nga titullari nuk është argumentuar llogaritja e fondit limit pasi nga AK nuk janë hartuar preventivat paraprakë të aktiviteteve, nuk janë analizuar nevojat për mallra dhe shërbime, AK ka përdorur dhe procedura të tjera prokurimi si prokurimi me blerje të vogla, duke anashkaluar procedurën tender i hapur (materialet promovuese për panairë sic është botimi i

broshurave për promovimin e turizmit janë botime që duhet të përdoren në të gjitha këto panaire). Në këtë mënyrë nuk është bërë planifikimi i buxhetit sipas nevojave, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu V, pika 1/ç. Në zbatimin kontratës konstatohet se, mallrat e bëra dalje nga magazina për arredimin e stendës në panairin e Berlit, nuk rezultojn të jenë bërë hyrje në magazinë, pasi në kartelat e magazinës si dhe nga kontrolli fizik i saj, nuk konstatohet ky fakt, pra nuk dihet se a kanë shkuar në këtë panair pikërisht këto mallra për të cilat është tenderuar. Për tenderin me objekt **“Prodhimi i materialeve promocionale në kuadër të vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri”**, me vlerë kontrate **6,102,000 lekë** (me TVSH), përzgjedhja e procedurës së prokurimit është bërë në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 2/c të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006” i ndryshuar, dhe nenit 43, pika 7 ligjit nr.9643, datë 20.11.2006. Llogaritja e fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike është bërë në kundërshtim me kreun II, pika 2/ç dhe c të VKM nr.1, datë 10.01.2007 i ndryshuar. Në hartimin DST janë vendosur kritere në kundërshtim me Kreun I, neni 3, pika 6 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar. Në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave KVO ka klasifikuar OE fitues me mangësi në plotësimin e dokumentacionit për pjesëmarrje në tender në kundërshtim me kreun V, pika 4 e VKM nr.1, datë 10.01.2007 e ndryshuar. Gjithashtu në përgatitjen e dokumenteve standarde të tenderit konstatohet se për “kapacitetin teknik” është kërkuar një numër punonjësish jo më pak se 35 vetë për periudhën 01janar-31 qershor 2014, kriter i cili nuk tregon gjendjen reale të punonjësve në dispozicion pasi nuk jep garanci nëse ky numër punonjësish në dispozicion deri në fund të qershorit 2014, jep garanci për realizimin e kontratës, në një kohë që tenderi zhvillohet në 13.8.2014, kjo në kundërshtim me Kreun III, pika 3/c, të VKM nr.1 datë 10.01.2007 e ndryshuar.

-Për mbështetjen e aktivitetit TRAKU FEST dhe mbulimin e tij nëpërmjet copëzimit të fondeve. Relacioni mbi mundësinë e mbështetjes së aktivitetit është përgatitur nga Znj. ...., sipas shkresës nr.655/1 prot, datë 29.07.2014. Ky relacion i referohet kërkesës të subjektit P....., drejtuar disa Ministrive dhe AKT, për mbështetje aktiviteti. Siç sqarohet në kërkesë, TRAKU FEST është Festival i Trashëgimisë Kulturore, që ka për qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare tek të rinjtë, si dhe turizmin kulturor në jugun e Shqipërisë. Gjatë TRAKU FEST do të ofrohen një numër i madh aktivitetesh të shtrira në katër ditë, duke i ofruar secilit qytetar një zgjidhje midis konferencave akademike, festimeve tradicionale, vizitave të organizuara dhe koncerteve masive me grupe të njohura. Për këtë aktivitet, janë bërë pagesa për një aktivitet si Festival i Trashëgimisë Kulturore, në gjykimin tonë jo të lidhur direkt me promovimin e turizmit por fakti është se janë copëzuar fonde për realizimin e tij. Shpenzimet, duke mos qenë të mbështetura nga ana ligjore, janë të pajustificuara dhe përbëjnë shkelje të disiplinës financiare.

Gjithashtu, në rolin e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor ka lejuar shkeljen e rregullave për zbatimin e procedurave të prokurimit, duke miratuar përdorimin e procedurave emergjente për blerjet me vlera të vogla për mallra e shërbime gjatë vitit 2014, kështu:

a)USH nr.264, datë 5.09.2014, shpenzime për qiramarrje automjeti (2 minibusë 20+1 dhe 1 furgon mallrash), vlera 378 mijë lekë, subjektit A....., sipas faturës tatimore nr.2645, datë 4.08.2014.

b)USH nr.267, datë 9.09.2014, pagesë akomodimi (Tak Fest), në Hotelin K....., Gjirokastrë, sipas faturës tatimore nr.357, datë 5.08.2014, vlera 45 mijë lekë. Urdhri për kryerjen e pagesës nr.278, datë 14.08.2014, të akomoduarit janë 17 persona në periudhën 31 korrik-3 gusht.

c)USH Nr.270, datë 9.09.2014, pagesë të aktivitetit TRAKU FEST, shuma 115 500 lekë, faturë tatimore nr.823, datë 4.08.2014 të Ç..... Gjirokastrë, akomoduar 18 persona në 18 dhoma, për 2 net për periudhën 31 korrik-3gusht 2014.

ç)USH Nr.271, datë 9.09.2014, pagesë të aktivitetit TRAKU FEST (akomodim në hotel), shuma 42 000 lekë, faturë tatimore nr.304, datë 6.08.2014 të A..... Gjirokastrë, akomoduar 10 persona në 7 dhoma, për 2 net për periudhën 31 korrik-3gusht 2014.

d)USH Nr.272, datë 9.09.2014, pagesë të aktivitetit TRAKU FEST, shuma 57 000 lekë, faturë tatimore nr.592, datë 3.08.2014 subjektit V....., akomoduar 12 persona, në 5 dhoma me nga tre net dhe 2 dhoma me nga 2 net në periudhën 31 korrik-3gusht 2014.

e)USH Nr.315, datë 3.10.2014, pagesë të aktivitetit TRAKU FEST, shuma 21000 lekë, faturë tatimore nr.164, datë 3.08.2014 të subjektit D....., akomoduar 5 persona në 2 dhoma nga dy net dhe 3 dhoma me 1 natë (31 korrik-3gusht 2014).

f)USH Nr.316, datë 3.10.2014, pagesë të aktivitetit TRAKU FEST, shuma 78 mijë lekë, faturë tatimore nr.173, datë 3.08.2014 të subjektit L..... Gjirokastrë, akomoduar 14 persona në 7 dhoma nga tre net dhe 4 dhoma me 1 natë (31 korrik-3 gusht 2014).

Pagesa rreth 740 mijë lekë, është bërë në favor të aktivitetit të një subjekti, për të cilin AKT nuk ka asnjë dokumentacion për regjistrimin si subjekt fizik apo juridik, certifikatë të QKR-së, licencë profesionale etj. Shpenzimet janë kryer kryesisht për transportin e personave nga Tirana në Gjirokastrë e kthim dhe për akomodim fjetje në hotel, të cilat nuk kanë lidhje thelbësore me objektin e qëllimin e Agjencisë Kombëtare të Turizimit, përcaktuar në Ligjin për Turizmin.

-Për mbështetjen e aktivitetit “Festa e birrës” Korçë, pasi nuk sqarohet lidhja “Festa e Birrës” me aktivitetin turistik të AKT, për më tepër AKT ka përballuar shpenzimet e aktivitetit, duke paguar qira për stola e tavolina e jo për aktivitet turistik.

1)Me USH Nr.275, datë 16.09.2014 është kryer transaksioni për shpenzimet e bëra për aktivitetin Festa e Birrës Korçë (broshura), në vlerën 346 800 lekë, pagesë e kryer në favor të subjektit P..... shpk. Procedurat për aktivitetin janë bërë me blerje me vlera të vogla (me sistemin elektronik), në përfundim është shpallur fitues P..... shpk. Nga operatori ekonomik është paraqitur fatura tatimore nr.104, datë 13.08.2014, me vlerë 346 800 lekë me TVSH.

2)Me USH nr.284, datë 16.09.2014, është kryer transaksioni për mbulimin e shpenzimeve të bëra për aktiviteti Festa e Birrës (qira pajisje), në favor të subjektit J....., sipas faturës tatimore nr.35, datë 18.08.2014 (qira për 220 copë stola e tavolina), vlera 429 600 lekë.

*-Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në subjektet që kanë përfituar asistencë financiare, konstatohet se për vitin 2013 dhe 2014, ne asnjë rast nuk është kryer kontroll në lidhje me zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet që kanë përfituar*

statusin "person i stimuluar", referuar kreut III, neni 9, pika 2/d, nenit 48/2 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin" me ndryshime si dhe kreut I, pika III/d, të Rregullores së brendshme.

Si rezultat nuk gjendet asnjë dokument zyrtar (procesverbal/akt konstatimi) që të vërtetojë nëse janë ushtruar kontrole, nëse subjektet vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin, kanë humbur karakterin turistik të ndërtimeve apo nuk ekzistojnë fizikisht në terren si ndërtime. Për pasojë detyrimi i qirasë dhe zhvillimit i mbartur ndër vite deri deri në fund të 2014, për 39 subjekte që kanë lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi, rezulton në vlerën **637,176,777** lekë (dhe pse marrëveshjet janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga ana e ministrisë përgjegjëse për turizmin) ndërkohë që 6 prej tyre vazhdojnë aktivitetin. Vetëm për subjektin S..... me statusin "person i stimuluar", nuk gjendet asnjë e dhënë nëse ka filluar aktivitetin e zhvillimit apo vazhdon të qëndrojë në truallin ku pronar është "shteti" të cilin e ka marrë me qira. Detyrimi deri në janar 2014 për këtë subjekt, është në vlerën 298,498,967 lekë, i cili vjen duke u rritur nga viti në vit dhe ndikon në rritjen fiktive të detyrimeve debitorë për faktin se nuk ka asnjë të dhënë për subjektet (fakt i cilësuar edhe në raportin e auditit të brendshëm të ministrisë).

-Nga auditimi i ushtruar në lidhje me detyrimin ligjor të AKT për vitin 2013 dhe 2014, në përmbushje të detyrimeve të saj, në zbatim të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin" me ndryshime, VKM nr. 571, datë 5.9.2007 "Për miratimin e Statutit të Agjencisë Kombëtare të Turizmit" dhe Rregullores së Brendshme, konstatohet se nuk është përmbushur detyrimi ligjor për hartimin e programeve të dhënies së asistencës financiare, për projektet me përparësi turizmin, për pasojë nuk kemi asnjë tregues për përmirësimin e këtij sektori.

*-Nga auditimi mbi marrjen me qira të ambienteve për magazinim për vitin 2014, rezulton se:*

Për periudhën nga 12.03.2014 deri më 12.01.2015 AKT, ka marrë me qira një ambient me sipërfaqe prej 700 m<sup>2</sup>, në adresën rruga Gjergj Balsha, nr.6 pranë Urës Kamëz, Tiranë, për tu përdorur si magazinë për nevojat e institucionit shoqërisë P..... referuar kontratës me nr. 295 prot, datë 12.03.2014, me vlerë 36 000 lekë/muaj, e pa justifikuar dhe e pa argumentuar, pasi AKT është akomoduar pranë godinës të Ministrisë së Zhvillimit nga data 01.04.2014, në të cilën përveç ambienteve të zyrave në dispozicion ka në administrim të saj nga momenti i transferimit dhe dy magazina. **Nga ky moment nevojat për magazinim për AKT përballohen nga transferimi i kryer në ambientet e MZHUT.**

Nga verifikimi i kryer në vend më datën 09.01.2015 në magazinën e marrë me qira prej 700m<sup>2</sup> nga grupi i auditimit së bashku me përfaqësuesit e institucionit, rezultoi se:

- Ambienti i marrë me qira për periudhën 9 mujore nga data e lidhjes së kontratës nuk ka qene ne eficientë si magazinë, pasi institucioni nuk ka magazinuar asnjë artikull referuar dokumenteve të magazinës. Nga verifikimi i dokumentacionit të magazinës rezultoi se i vetmi artikull, në administrim të AKT i cili u evidentua në këtë magazinë është konstrukcion metalik copë 1 me çmim 456,000 lekë/copë në vlerë 456,000 lekë është vendosur në këtë magazinë (me qira) me datë 18.12.2014 sipas fletë hyrjen nr.109, datë 18.12.2014, pra pas 9 muajsh pagesë qiraje për këtë magazinë. Kjo përforcon konstatimin e grupit të auditimit se nuk kishte asnjë domosdoshmëri dhe



nevojë për ambiente të tjera për magazinë për tu marrë me qira. *Pra nga verifikimi në vend i këtij ambjenti nuk rezultoi se i shërbente institucionit për faktin se aty gjendeshin artikuj mallra të ndryshëm të shoqërisë P..... shpk, të trajtuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.* Ambienti nuk e kryen funksionin e objektit të kontratës së lidhur me 12.03.2014, pasi ambienti nuk i plotëson kushtet e të qenit magazinë. Nga ana e institucionit nuk disponohet hyrja dhe dalja lirshëm nga ky ambient, pasi institucioni nuk disponon çelësat e këtij ambjenti, hyrja dhe dalja nga ky ambient kryhej nga rojet e shoqërisë P..... shpk (qiradhënësi), nuk është i ndarë nga sipërfaqja tjetër prej 19,726 m<sup>2</sup> e subjektit P..... shpk, duke mos siguruar kushtet minimale të sigurisë së mallrave objekt magazinimi. Shuma e pagesave për qira magazine deri më 31.12.2013 të kryera nga institucioni referuar ditarit të bankës është në shumën prej 288,000 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare pasi bie ndesh me neni 4/germa ç të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, neni 2, neni 8, neni 12, neni 13 të Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Pagesat e kryera me urdhër të Titullares janë bërë duke keqpërdorur fondet buxhetore. Gjithashtu nga verifikimet e kryera në vend datë 9.01.2015, nuk u konstatuan mallra e materiale të identifikueshme sipas rregullave të kontabilitetit. Malli i vetëm i gjetur në vlerë 456,000 lekë, u bë hyrje në magazinë me datë 18.12.2014, pas 9 muaj likuidimi qiraje. Këto veprime bien ndesh me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“ dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4/germa ç, neni 2, neni 8, neni 12, neni 13.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Miranda HAXHIA p/grupi, Vjollca Selmani, Fadil Dekovi dhe Alma Shehu, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit.